



United Nations
Nations Unies



International Criminal Tribunal
for the former Yugoslavia
Tribunal Pénal International
pour l'ex-Yougoslavie

(IT-02-54)

SLLOBODAN MILLOSHEVIQ

**SLLOBODAN
MILLOSHEVIQ**

U akuzua për gjenocid; bashkëpunim në gjenocid; dëbim; vrasje; përndjekje politike, racore ose fetare; veprime çnjerëzore/ zhvendosje me forcë, shfarosje; burgosje; torturë; vrasje të qëllimshme; burgosje të paligjshme; shkaktim të vuajtjes së madhe të qëllimshme; dëbim apo zhvendosje të qëllimshme; shkatërrim të gjerë dhe përvetësim të pronës, e pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake dhe e kryer në mënyrë joligjore dhe pa arsye; trajtim mizor; plaçkitje të pronës publike ose private; sulme ndaj civilëve; shkatërrim ose dëmtim të qëllimshëm të monumenteve historike dhe institucioneve arsimore ose fetare; sulme të paligjshme mbi objekte civile; shkaktim të qëllimshëm të vuajtjes së madhe.



Slobodan MILLOSHEVIQI, Kryetar i Serbisë nga 26 dhjetori 1990; Kryetar i Rrepublikës Federative të Jugosllavisë (RFJ-së) nga 15 korriku deri më 6 tetor 2000. Si Kryetar i RFJ-së ai gjithashtu ishte Kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes së RFJ-së dhe Komandant Suprem i Ushtrisë Jugosllave, i lindur më 20 gusht 1941 në Pozharec, Serbi dhe Mali i Zi.

- Vdiq më 11 mars 2006
- Procedura gjyqësore përfundoi më 14 mars 2006

SLLOBODAN MILLOSHEVIQ

Aktakuza

“Kosovë”: aktakuza e parë: 24 maj 1999; aktakuza e ndryshuar; 29 qershor 2001; aktakuza e ndryshuar për herë të dytë: 29 tetor 2001

“Kroaci”: aktakuza e parë: 8 tetor 2001; aktakuza e ndryshuar: 23 tetor 2002; aktakuza e ndryshuar për herë të dytë: 28 korrik 2004.

“Bosnjë dhe Hercegovinë”: aktakuza e parë: 22 nëntor 2001; aktakuza e ndryshuar 22 nëntor 2002.

I arrestuar

1 prill 2001 në Beograd nga autoritetet vendore

I transferuar në TPNJ

29 qershor 2001

Paraqitja fillestare

3 korrik 2001, Dhoma Gjyqësore bëri deklarin e pafajësisë në vend të tij për të gjitha pikat e aktakuzës për Kosovën
29 Tetor 2001, Dhoma Gjyqësore bëri deklarin e pafajësisë në vend të tij për të gjitha pikat e aktakuzës për Kroacinë
11 Dhjetor 2001, Dhoma Gjyqësore bëri deklarin e pafajësisë në vend të tij për të gjitha pikat e aktakuzës për Bosnjën

Krimet për të cilat akuzohet (shembuj):

KOSOVË

- Dëbim me forcë i përafërsisht 800 000 civilëve shqiptarë të Kosovës mundësuar prej një atmosfere të krijuar qëllimisht për përhapjen e frikës dhe shtypjes nëpërmjet përdorimit të forcës, kërcënimit me forcë dhe akteve të dhunës.
- Vrasjet e qindra civilëve shqiptarëve të Kosovës – burra, gra dhe fëmijë, që u kryen në mënyrë të gjerë ose sistematike anembanë krahinës të Kosovës.
- Sulme seksual nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë kundër shqiptarëve të Kosovës, në veçanti kundër femrave.

- Fushatë të përhapur ose sistematike të shkatërrimit të pronave të civilëve shqiptarë të Kosovës, e cila u arrit me granatimin e gjerë të qyteteve dhe fshatrave; djegjen dhe shkatërrimin e pronës, përfshirë shtëpitë, fermat, bizneset, monumentet kulturore dhe vendet fetare; dhe shkatërrimin e pronës private, që bëri fshatra, qytetet dhe rajone të tëra, të pabanueshme për shqiptarët e Kosovës.

KROACIA

- Shfarosjen ose vrasjen e qindra civilëve kroatë dhe civilëve të tjerë joserbë, përfshirë gra dhe pleq, në Dal, Erdut, Klisa, Lovas, Vukovar, Voqin, Baqin, Saborsko dhe fshatrat fqinje Shkabrnja, Nadin, Bruska, dhe Dubrovnik me rrethinë.
- Burgosje dhe privim nga liria në mënyrë të zgjatur dhe të përsëritur të mijëra civilëve kroatë dhe civilëve të tjerë joserbë në objekte burgimi brenda dhe jashtë Kroacisë, duke përfshirë kamp-burgjet në Mal të Zi, Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë.
- Dëbimin me forcë të së paku 170.000 civilëve kroatë dhe civilëve të tjerë joserbë nga territoret e lartpërmendura, duke përfshirë dëbimin e së paku 5.000 banorëve të Lokut për në Serbi, 20.000 banorë nga Vukovari; dhe zhvendosjen me forcë në vendndodhje brenda Kroacisë të së paku 2.500 banorëve nga Erduti.
- Shkatërrimin e qëllimshëm të shtëpive, pronës tjetër private dhe publike, institucioneve kulturore, monumenteve historike dhe vendeve të shenjta të kroatëve dhe popullatës tjetër joserbe në Dubrovnik dhe rrethinë, Vukovar, Erdut, Lovas, Sharengard, Bapska, Tovarnik, Voqin, Saborsko, Shkabrnja, Nadin, dhe Bruska.
- Imponimin dhe mbajtjen e kushteve çnjerëzore të jetesës për të burgosurit civilë kroatë dhe për të burgosurit e tjerë civilë joserbë brenda objekteve të përmendura të burgimit.
- Tortura, rrahje dhe vrasje të përsëritura të civilëve kroatë dhe civilëve të tjerë joserbë në objektet e përmendura të burgimit.
- Sulme të paligjshme ndaj Dubrovnikut dhe fshatrave kroate të pambrojtura anembanë territoreve të lartpërmendura.

BOSNJA DHE HERZEGOVINA

- Vrasje të përhapura të mijëra muslimanëve të Bosnjës gjatë dhe pas marrjes nën kontroll të territoreve brenda Bosnjës dhe Hercegovinës.
- Vrasjen e mijëra muslimanëve të Bosnjës në objektet e burgimit brenda Bosnjës dhe Hercegovinës.
- Shkaktim të dëmtimit të rëndë trupor dhe mendor ndaj mijëra muslimanëve të Bosnjës gjatë kohës së qëndrimit të tyre në objektet e burgimit brenda Bosnjës dhe Hercegovinës.
- Burgosjen e mijëra muslimanëve të Bosnjës në objektet e burgimit brenda Bosnjës dhe Hercegovinës në kushte jetese të llogaritura për shkatërrimin fizik të një pjese të atyre grupeve, nëpërmes urisë, ujit të ndotur, punës së detyruar, kujdesit mjekësor të papërshatshëm dhe sulmeve të përhershme fizike dhe psikologjike.
- Shfarosje, vrasje dhe vrasje me paramendim të joserbëve, kryesisht të muslimanëve të Bosnjës dhe kroatëve të Bosnjës që jetonin në territoret në Banja Llukë, Bihaq, Bijeljin, Bileqa, Bosanska Krupa, Bosanski Novi, Bosanski Shamac, Bratunac, Brčko, Çajniçe, Doboj, Foça, Gacko, Sarajev (Ilijash), Ključ, Kalinovik, Kotor Varosh, Nevesinje, Sarajevo (Novi Grad), Prijedor, Prnjavor, Rogatica, Sanski Most, Srebrenica, Tesliq, Vishegrad, Vlasenica dhe Zvornik.
- Trajtim mizor dhe çnjerëzor i civilëve muslimanë të Bosnjës, kroatë të Bosnjës, dhe joserbëve të tjerë. Këto trajtime çnjerëzore përfshinë dhunë seksuale, torturë, keqtrajtim fizik dhe psikologjik dhe ekzistencë e detyruar në kushte çnjerëzore të jetesës. po nuk kufizohen vetëm në këto.
- Imponim i masave shtrënguese dhe diskriminuese kundër muslimanëve të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe joserbëve të tjerë, si kufizimi i lirisë së lëvizjes; largimi nga pozitat me autoritet në institucionet qeveritare vendore dhe të policisë; largimi nga puna; bastisje arbitrare të shtëpive të tyre; refuzimi i të drejtës së procesit gjyqësor dhe refuzimi i së drejtës për barazi në përdorimin e shërbimeve publike, duke përfshirë kujdesin e përshtatshëm mjekësor.
- Zhvendosje dhe dëbim me forcë të mijëra civilëve muslimanë të Bosnjës, kroatë të Bosnjës dhe joserbëve të tjerë për në vendndodhje jashtë territoreve të mbajtura nga serbët.

- Shkatërrim të qëllimshëm dhe të paarsyeshëm të shtëpive dhe pronave të tjera private dhe publike të muslimanëve të Bosnjës dhe kroatëve të Bosnjës, të institucioneve të tyre kulturore dhe fetare, të monumenteve historike dhe vendeve të tjera të shenjta.
- Pengim të ndihmës humanitare, në veçanti të furnizimeve mjekësore dhe ushqimore në enklavat e rrethuara Bihaq, Gorazhde, Srebrenica dhe Zhepa, dhe lënien pa ujë të civilëve të mbërthyer në enklava, të formuara për krijimin e kushteve të padurueshme të jetesës.

GJYKIMI

Filloi më 12 shkurt 2002

Dhoma Gjyqësore III gjykatësi Richard May (Kryesues, deri më 31 maj 2004), gjykatësi Patrick Robinson (kryesues), gjykatësi O-Gon Kwon, gjykatësi Iain Bonomy

Amici curiae Michail Wladimiroff (6 shtator 2001 – 22 nëntor 2002)

Branislav Tapusković (6 shtator 2001 – 23 qershor 2003)

Steven Kay (6 shtator 2001 – 3 shtator 2004)

Timothy McCormack (prej 22 nëntorit 2002 deri përfundimin e procedurave gjyqësore)

Bashkëpunëtor ligjor Ramsey Clark dhe John Livingston (15 nëntor 2001 – 10 prill 2002)

Zdenko Tomanović dhe Dragosllav Ognjanović (prej 10 prillit 2002 deri në përfundimin e procedurave gjyqësore)

Branko Rakić (prej 23 tetorit 2003 deri në përfundimin e procedurave gjyqësore)

Avokatë të caktuar nga gjykata Steven Kay, Gillian Higgins (prej 3 shtatorit 2004 deri më përfundimin e procedurave gjyqësore)

Procedura gjyqësore përfundoi më 14 mars 2006

AKTAKUZA DHE AKUZAT

KOSOVË

Aktakuza e parë kundër Slobodan Millosheviqit, Millan Milutinoviqit, Nikolla Shainoviqit, Dragolub Ojdaniqit dhe Vlajko Stojiljkoviqit (lënda. IT-99-37), në lidhje me krimet e kryera në Kosovë, u konfirmua më 24 maj 1999 dhe u bë publike më 27 maj 1999. Kjo aktakuzë u ndryshua më 29 qershor 2001. Më 29 tetor 2001 Prokuroria paraqiti aktakuzën e ndryshuar për here të dytë. Më 5 shtator 2002, Dhoma Gjyqësore ndau procedurat gjyqësore kundër Slobodan Millosheviqit prej të akuzuarve të tjerë. Aktakuza në fuqi pohon se ndërmjet 1 janarit 1999 dhe 20 qershorit 1999, Slobodan Milosheviqi mori pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (NPK) së bashku me një numër individësh të tjerë duke përfshirë Millan Milutinoviqin, Nikolla Shainoviqin, Dragolub Ojdaniqin, Vlajko Stojiljkoviqin dhe të tjerë të njohur dhe të panjohur. Gjatë kësaj periudhe forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me ndihmën, ose me mbështetjen e NPK-së, kryen një fushatë terrori dhe dhune drejtuar kundër civilëve shqiptarë të Kosovës. Pohohet se qëllimi i NPK-së ishte dëbimi nga Kosova i një pjese thelbësore të popullsisë shqiptare të Kosovës, me qëllim që të sigurohej vashdimi i kontrollit serb mbi krahinën. Millosheviqi mban përgjegjësi individuale për krimet e deklaruara kundër tij, në bazë të Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit, dhe për krimet ose mosveprimet e vartësve të tyre, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit. Sipas aktakuzës, gjatë periudhës në fjalë, Slobodan Millosheviqi ishte Kryetar i RFJ-së, Kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes së RFJ-së dhe Komandant Suprem i Ushtrisë Jugosllave, (UJ). Në përputhje me pozitën e tij ai ushtroi autoritet komandues mbi UJ-në dhe forcat e policisë në vartësi të UJ-së. Përveç pushtetit të tij *de jure*, ai gjithashtu ushtroi kontroll *de facto* mbi institucione të shumta kyçe ose të përfshira në kryerjen e krimeve të deklaruara në aktakuzë. Më tej thuhet se përafërsisht 800.000 civilë shqiptarë të Kosovës u dëbuan nga krahina duke i larguar me forcë dhe duke plaçkitur dhe shkatërruar shtëpitë e tyre ose duke granatuar

fshatrat. Gjatë këtij procesi shumë u vranë dhe u keqtrajtuat dhe iu vodhën të mirat materiale dhe dokumentet e identifikimit.

KROACIA

Aktakuza e parë kundër Slobodan Millosheviqit në lidhje me krimet e kryera në Kroaci, u konfirmua më 8 tetor 2001 dhe u bë publike më 9 tetor 2001. Më 23 tetor 2002, Prokuroria paraqiti versionin e ndryshuar të aktakuzës "Kroacia". Aktakuza u ndryshua më tej më 26 korrik 2004. Kjo, aktakuzë e ndryshuar për herë të dytë u bë aktakuza në fuqi më 28 korrik 2004. Sipas aktakuzës, Slobodan Millosheviqi mori pjesë në NPK e cila filloi ekzistencën para 1 gushtit 1991 dhe vazhdoi deri më së paku qershor 1992. Individët që morën pjesë në NPK ndër të tjerë ishin Borisav Joviq, Branko Kostiq, Velko Kadijeviq, Blagoje Axhiqin, Millan Babiq, Millan Martiq, Goran Haxhiq, Jovica Stanishiq, Franko Simatoviq (gjithashtu i njohur si "Frenki"), Tomislav Simoviq, Vojislav Sheshel, Momir Bullatoviq, Aleksandar Vasiljeviq, Radovan Stojiçiq (gjithashtu i njohur si "Badzha"), Zhelko Razhnatoviq (gjithashtu i njohur si "Arkan") dhe pjesëmarrës të tjerë të njohur dhe të panjohur. Qëllimi i kësaj ndërmarrjeje ishte zhvendosja me forcë e shumicës së kroatëve dhe popullatës tjetër joserbe prej përafërsisht një të tretës së territorit të Republikës së Kroacisë, rajon të cilin ai planifikonte ta bënte pjesë të një shteti të ri të dominuar nga serbet. Ky rajon përbëhej prej atyre pjesëve që autoritetet serbe i quanin "Qarku Autonom Serb ("SAO") Krajina", "SAO Slavonia, Baranja dhe Sremi perëndimor" (territor të cilin prej 19 dhjetorit të 1991 autoritetet serbe e quanin me emrin e përbashkët "Republika e Krajinës Serbe (RSK") dhe "Republika e Dubrovnikut".

Sipas aktakuzës, gjatë periudhes në fjalë, Slobodan Millosheviqi ishte Kryetar i Republikës së Serbisë dhe si i tillë kishte kontroll efektiv ose ndikim të dukshëm mbi pjesëmarrësit e NPE-së, dhe se vetëm ose në bashkëpunim më të tjerët, kontrolloi efektivisht ose ndikoi thelbësisht në veprimet e Kryesisë Federative të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ-së) dhe më vonë në atë të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ), të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë /MPB/, Armatës Popullore të Jugosllavisë /APJ/, personelit të njësisë të Mbrojtjes Territoriale (TO) të udhëhequra nga serbët në territoret e lartpërmendura, si dhe grupet e vullnetarëve serbë.

Pohohet se midis 1 gushtit 1991 dhe qershorit të vitit 1992 forcat serbe të përbëra prej njësisë të Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ), njësisë të Mbrojtjes Territoriale (TO) të atjeshme si dhe njësisë TO nga Serbia dhe Mali i Zi, njësisë vendore dhe policore të Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme ("MUP"), dhe njësisë parashtarake, sulmuan dhe morën nën kontroll qytete, fshatra dhe vendbanime në territoret e lartpërmendura. Pas marrjes nën kontroll, forcat serbe, në bashkëpunim me autoritetet vendore serbe, vendosën regjimin e përndjekjeve me qëllim të largimit të popullatës kroate dhe asaj joserbe nga këto territore.

Ky regjim ndër të tjera përfshiu shfarosjen ose vrasjen e qindra civilëve kroatë ose joserbë të tjerë, duke përfshirë gra dhe pleq, dëbimin ose zhvendosjen me forcë të së paku 170 000 civilëve kroatëve dhe civilëve të tjerë joserbë, dhe privimin e lirisë ose burgosjen në kushte çnjerëzore të mijëra civilëve kroatë dhe civilëve të tjerë joserbë. Gjithashtu në të gjitha rajonet në fjalë, u shkatërruan qëllimisht dhe pa arsye prona private dhe publike, ndër të tjera shtëpi, ndërtesa fetare, historike dhe kulturore.

BOSNJA AND HERZEGOVINA

Aktakuza e parë kundër Slobodan Millosheviqit në lidhje me krimet e kryera në Bosnjë dhe Hercegovinë u konfirmua më 22 nëntor 2001 dhe u bë publike më 23 nëntor 2001. Më 22 nëntor 2002, Prokuroria paraqiti variantin e ndryshuar të aktakuzës. Më 21 prill 2004, ky variant i aktakuzës hyri në fuqi. Aktakuza pohon se Millosheviqi mori pjesë në NPK e cila ekzistonte prej 1

gushtit 1991 dhe vazhdoi deri më së paku 31 dhjetor 1995. Ndër individët të cilët morën pjesë në NPK ishin Radovan Karaxhiq, Momçillo Krajishnik, Biljana Plavshiq, Ratko Milladiqi, Borisav Joviqi, Branko Kostiq, Velko Kadijejiq, Bllagoje Axhiqi, Millan Martiq, Jovica Stanishiq, Franko Simatoviq (gjithashtu i njohur si "Frenki"), Vojislav Shesheli, Radovan Stojiçiq (gjithashtu i njohur si "Bagja"), Zhelko Razhnatoviq "Arkan" dhe pjesëmarrës të tjerë të njohur dhe të panjohur. Qëllimi i NPK-së ishte largimi me forcë dhe përfundimtar i shumicës së joserbëve, kryesisht i muslimanëve të Bosnjës dhe kroatëve të Bosnjës nga territoret të mëdha të Bosnjës dhe Hercegovinës. Sipas aktakuzës, gjatë periudhës që ka lidhje me të, Slllobodan Millosheviqi ishte Kryetar i Serbisë dhe si i tillë ushtroi kontroll efektiv ose ndikim thelbësor mbi pjesëmarrësit e NPK-së dhe se vetë ose në bashkëpunim me ta dhe me persona të tjerë të njohur dhe të panjohur kontrolloi efektivisht ose ndikoi ndjeshëm në veprimet e Kryesisë Federative të RSFJ-së më vonë RFJ-së, MPB-së, Armatës Popullore të Jugosllavisë, APJ, dhe më vonë UJ-së, Armatës Serbe të Bosnjës (VRS), si dhe të grupeve parashtarake serbe.

Akuzohet se prej 1 marsi 1992 ose rreth kësaj date deri më 31 dhjetor 1995, Slllobodan Milosheviqi, duke vepruar vetë ose në bashkëpunim me pjesëmarrësit e tjerë të NPK-së, planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose ndryshe ndihmoi dhe inkurajoi planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e vrasjeve të shumta të mijëra muslimanëve të Bosnjës gjatë dhe pas marrjes nën kontroll të territoreve brenda Bosnjës dhe Hercegovinës dhe burgosjen e mijëra muslimanëve të Bosnjës në objektet e burgimit brenda Bosnjës dhe Hercegovinës, në kushte jetese të llogaritura për shkaktimin fizik të një pjese të atyre grupeve. Gjatë qëndrimit të tyre në objektet e burgimit, mijëra muslimanë të Bosnjës u vranë ose pësuan dëmtime të rënda trupore dhe mendore. Si bashkëkryes në NPK, Millosheviqi gjithashtu mbante përgjegjësi për shfarosjen ose vrasjen dhe zhvendosjen me force dhe dëbimin e mijëra civilëve muslimanë të Bosnjës, kroatë të Bosnjës dhe civilë të tjerë joserbë. Akuzat gjithashtu përfshijnë veprime të shumta të shkatërrimit të qëllimshëm dhe të paarsyeshëm të shtëpive, dhe pronave të tjera të muslimanëve dhe kroatëve të Bosnjës, si dhe të institucioneve të tyre kulturore dhe fetare, monumenteve historike dhe vende të tjera të shenjëta dhe përvetësimin dhe plaçkitjen e pronave të civilëve muslimanë të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe civilëve të tjere joserbë. Në bazë të përgjegjësisë individuale penale (Neni 7(1) i Statutit të Tribunalit), dhe në bazë të përgjegjësisë penale të eprorit (Neni 7(3) i Statutit), Slllobodan Millosheviqi u akuzua për:

KOSOVË

- Dëbim; vrasje; përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare; dhe veprime të tjera çnjerëzore/zhvendosje me forcë (krime kundër njerëzimit, Neni 5),
- Vrasje (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Neni 3).

KROACI

- Përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare; shfarosje; vrasje; burgosje; torturë; veprime çnjerëzore; dëbim; veprime çnjerëzore (zhvendosje me forcë) (krime kundër njerëzimit, Neni 5),
- Vrasje të qëllimshme; heqje të paligjshme e lirisë; torturë; shkaktim të qëllimshëm të vuajtjeve të mëdha; dëbim ose zhvendosje të paligjshme; shkatërrim të gjerë dhe përvetësim të pronës të pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake dhe kryer në mënyrë të paligjshme dhe pa arsye (shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, Neni 2),
- Vrasje; torturë; trajtim mizor; shkatërrim pa arsye të fshatrave, ose shkatërrim të madh i pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake; shkatërrim ose dëmtim të qëllimshëm të institucioneve arsimore ose fetare; plaçkitje të pronës private ose publike; sulme kundër civilëve; shkatërrim ose dëmtim pa arsye të monumenteve historike dhe institucioneve arsimore ose fetare; sulme të paligjshme mbi objekte civile (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Neni 3).

BOSNJA DHE HERCEGOVINA

- Gjenocid; bashkëpunim në gjenocid (gjenocid, Neni 4),

- Përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare; shfarosje; vrasje; burgosje; torturë; dëbim; veprime çnjerëzore; dhe zhvendosje me forcë (krime kundër njerëzimit, Neni 5),
- Vrasje të qëllimshme; heqje të paligjshme të lirisë; torturë; shkakim të qëllimshëm të vuajtjeve të mëdha; dëbim ose zhvendosje të paligjshme; dhe shkatërrimtëi gjerë dhe përvetësim të pronës (shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, Neni 2),
- Vrasje; torturë; trajtim mizor; shkatërrim pa arsye të fshatrave, ose shkatërrim të madh i pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake; shkatërrim ose dëmtim të qëllimshëm të institucioneve arsimore ose fetare; plaçkitje të pronës private ose publike; sulme kundër civilëve (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Neni 3).

AMICI CURIAE, AVOKATËT E CAKTUAR DHE BASHKËPUNËTORËT LIGJORË

Slobodan Milosheviqi zgjodhi të përfaqësohej vetë para Tribunalit. Në mungesë të avokatit mbrojtës të kualifikuar dhe për garantimin e një gjyqi të drejtë, më 30 gusht 2001, Dhoma Gjyqësore nxori një urdhëresë për Sekretarin për caktimin e avokatit për paraqitje para Dhomës si *amici curiae*. Më 6 shtator 2001, Sekretari caktoi Steven Kay-in, Branislav Tapushkoviçin dhe Michail Wladimiroff-in. *Amici curiae* nuk u emëruan për të përfaqësuar të akuzuarin por për të ndihmuar në përcaktimin e duhur të çështjes. Me kërkesën e të akuzuarit për marrjen e këshillimit ligjor nga Ramsey Clark dhe John Livingston, Dhoma Gjyqësore, më 15 nëntor 2001 lëshoi një urdhër i cili u dha atyre statusin e këshilltarit ligjor. Në këtë cilësi, Ramsey Clark-ut dhe John Livingston-it iu lejua kontakt i privilegjuar me të akuzuarin, çka do të thotë se komunikimet e tyre me të akuzuarin, qoftë në takime ose në telefon nuk vëzhgoheshin nga autoritetet e Tribunalit. Më 10 prill 2002, i akuzuari identifikoi në gjyq Zdenko Tomanoviçin dhe Dragoslav Ognjanoviçin si bashkëpunëtorë me të cilët ai dëshironte të komunikonte. Më 16 prill 2002, Dhoma Gjyqësore lëshoi një urdhëresë me të cilën zëvendësoi Ramsey Clark-un dhe John Livingston-in dhe emëroi Zdenko Tomanoviçin dhe Dragoslav Ognjanoviçin si juristë me të cilët i akuzuari do të mund të komunikonte për përgatitjen e mbrojtjes së tij. Dhoma Gjyqësore përcaktoi se si të tillë, ata duhet t'i nënshtroheshin Kodit të Sjelljes Profesionale për Avokatë të Mbrojtjes që Paraqiten Para Tribunalit Ndërkombëtar dhe do të ishin në varësi të urdhëresave ekzistuese të Dhomës mbi masat e mbrojtjes. Më 23 tetor 2003, Dhoma Gjyqësore e zgjeroi urdhëresën me qëllim që t'i mundësonte të akuzuarit komunikimin me Branko Rakiçin në kushte të njëjta. Më 10 tetor 2002, Dhoma Gjyqësore tërhoqi emërimin e Michail Wladimiroff-it si *amicus curiae*.

Më 22 nëntor 2002, Dhoma Gjyqësore caktoi Timothy McCormack-un si *amicus curiae* të tretë. Më 27 qershor 2003, Dhoma Gjyqësore bëri të ditur se për shkak përfundimit të paraqitjes së lëndës prej Prokurorisë, nuk ishin më të nevojshme shërbimet e *amicus curiae* Branislav Tapushkoviç. Më 3 shtator 2004, në pajtim me një urdhëresë të Dhomës Gjyqësore, Sekretari emëroi avokatin për Slobodan Milosheviçin: Steven Kay u emërua si avokat dhe Gillian Higgins si avokat ndihmës.

GJYKIMI

Gjykimi filloi më 12 shkurt 2002 më dëshmi në lidhje vetëm me akuzat për Kosovën. Prokuroria e përfundoi paraqitjen e argumenteve të veta në lidhje me Kosovën më 11 shtator 2002. Më 26 shtator 2002, Prokuroria filloi paraqitjen e argumenteve në lidhje me Kroacinë dhe Bosnjën e Hercegovinën. Prokuroria përfundoi paraqitjen e dëshmive kryesore të saj më 25 shkurt 2004. Më 12 prill 2004, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së emëroi Lordin Bonomy si gjykatës të TPNJ-së. Emërimi i Lordit Bonomy, hyri në fuqi më 1 qershor 2004. Lordi Bonomy zëvendësoi gjykatësin Richard May i cili ishte larguar për shkak të problemeve shëndetësore. Mbrojtja filloi paraqitjen e argumenteve të saj më 31 gusht 2004.

PROCEDURA SIPAS RREGULLËS 98bis

Më 16 qershor 2004, pas përfundimit të paraqitjes së argumenteve nga Prokuroria, Dhoma Gjyqësore gjykoi se kishte dëshmi të mjaftueshme në mbështetje të çdo akuze në të tri aktakuzat. Mirëpo, në pajtim me rregullën 98*bis*, Dhoma Gjyqësore gjithashtu gjykoi se nuk kishte ose kishte dëshmi të pamjaftueshme në mbështetje të disa deklaratave që kishin lidhje me disa nga akuzat në aktakuzat për Kroacinë dhe Bosnjë Hercegovinën. Deklaratat e hedhura poshtë përfshijnë:

- Ekzistencën, kushtet, organizimin dhe krimet e mundshme të kryera në objekte burgimi, të përshkruara si në paragrafet 64(b), 64(f), 64(h) dhe 64(p) në aktakuzën në lidhje me Kroacinë.
- Numrat e deklaratave nga Lista A (vrasjet që nuk kanë lidhje me objektet e burgimit); Lista B (vrasje të cilat kanë lidhje me objektet e burgimit); Lista C (ekzistenca e burgjeve); dhe Lista D (zhvendosja me forcë e civilëve joserbë) nga aktakuza "Bosnja".
- Të gjitha përveç një prej 44 incidenteve të pretenduara me snajper në Sarajevë.
- Të gjitha përveç një prej 26 incidenteve të pretenduara të granatimit në Sarajevë.

PËRFUNDIMI I PROCEDURAVE GJYQËSORE

Slobodan Millosheviqi vdiq më 11 mars 2006.

Më 14 mars 2006, Dhoma Gjyqësore përfundoi procedurat gjyqësore kundër të akuzuarit.

Dokument i përgatitur prej Shërbimit të Komunikimit. Të tëra dokumentet kryesore të TPNJ-së gjenden në: www.un.org/icty
Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Churchillplein 1, 2517 JW The Hague, Netherlands.